



NË DEMOKRACI


DEMOKRACIA, SISTEM I VLERAVE TË MËDHA

ENSARA (14), AURORA (14), BURIM (13), ERIS (14), ERIJONA (14)



Lexues të dashur, a e dini pse demokracia është sistem i vlerave të mëdha? Këtë do ta mësoni nga grupi që ka mësuar pikërisht për këtë temë

Demokracia i jep vlerë dhe fuqi secilit qytetar. Kjo ndodh sepse të gjithë i kanë të drejtat e barabarta dhe i gëzojnë të gjitha vlerat demokratike. Në demokraci është i gjithë populli, ai i cili e përcakton të ardhmen



Zëri i popullit në veprim

e vendit e jo vetëm një individ i caktuar. Këtë e diskutuam edhe në grupin tonë të vogël. Krijua një situatë hipotetike lidhur me atë se si do të ishte nëse vendi ynë do të udhëhiqej vetëm nga një person. Kjo situatë, nuk na pëlqeu aspak, për arsye se na i humbiste vlerat që i kemi si qytetarë. E vlerat tona që i kemi si qytetarë janë: e drejta e votës, e drejta e të shprehurit lirshëm, barazia gjinore, toleranca, solidariteti ndaj njëri-tjetrit, etj. Për këtë arsye e çmojmë dhe e vlerësojmë demo-

kracinë. Demokracia për herë të parë u shfaq në vitin 507 para erës së re, në kryeqytetin e Greqisë, Athinën. Mirëpo, nuk ishte e përparuar si në ditët e sotme. Atë kohë shkeleshin shumica e të drejtave të njeriut. Kurse tash në kohën tonë ka barazi gjinore dhe të drejta të shumta. Secili mund të votojë i lirë që nga moshën 18 vjeçare. E secili mund ta shpreh mendimin e vet lirshëm dhe të jetë pjesë aktive në vendimmarrje. Vlen të theksohet se shteti ynë Kosova ka demokraci përfaqësuese me sistem parlamentar. Kjo i bie se populli në procesin zgjedhor zgjedh deputetët, të cilët janë përfaqësuesit e popullit dhe të cilët punojnë në Kuvend. Prandaj, qytetarë të nderuar, ju e dini se jeni pjesë e një shteti demokratik dhe kërkohet nga ju që të kontribuoni në ndërtimin e mëtutjeshëm të demokracisë. Andaj, bëhuni qytetarë aktiv të këtij vendi. Ju jeni krijuesit e së ardhmes suaj, andaj krijoheni atë për bukuri.



Demokratët e Kosovës

INSTITUCIONI MË DEMOKRATIK

FIDAN (15), ERLIND (14), MEDINA (14), SUMEJA (14), DAFINA (14)



Deputetët janë përfaqësuesit e popullit


A dëshironi të dini për demokracinë, ligjet dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës? Nëse po, ju ftojmë ta lexoni këtë artikull

Të jetosh në një vend demokratik do të thotë të kesh të drejta të barabarta dhe ta kesh lirinë për të shprehur mendimin. Të drejtat tona janë të garantuara me ligj. Ligjet janë rregulla, të cilat ne si qytetarë duhet t'i zbatojmë dhe t'i respektojmë. Shqyrtimi, miratimi ose jo miratimi i ligjeve bëhet në institucionin më demokratik, pra në Kuvend. Ky funksion i Kuvendit njihet si funksioni legjislativ.

Në Kuvend merren vendime të rëndësishme për popullin tonë. Ato vendime ndikojnë në mënyrën se si funksionon shteti ynë, Kosova. Kuvendi zgjedh Presidentin e shtetit. Për shkak që njëra nga elementet më të rëndësishme në demokraci është barazia, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, përveç përfaqësuesve të kombit shqiptar, ka përfaqësues edhe të komuniteteve të tjera. Prandaj, prej gjithsej 120 deputetëve, 20 vende janë të garantuara për komunitetet jo shumicë. Këto komunitete janë: serb, boshnjak, egjiptian, ashkali, romë, turk dhe goran.

Përveç funksionit legjislativ, Kuvendi ka edhe funksionin kontrollues, sepse kontrollon Qeverinë. Pra, kontrollon punën e Kryeministrit, zv.kryeministrave, ministrave dhe zv.ministrave. Përderisa populli zgjedh deputetët si përfaqësues të tij, grupi ynë mendon se


çdo vendim duhet ta marrim me shumë përgjegjësi, sepse vendimet tona ndikojnë drejtpërdrejt në jetën tonë.



Salla ku mbahen seancat plenare



Grupi „Demokratët e Rinjë“



Ndërtesa e Qeverisë së Kosovës




Dafina duke e vizatuar ndërtesën e Qeverisë



Labi duke e përgatitur vizatimin që po shihni në anën e djathtë



Kompjuteri personal, pa të cilin shumë njerëz në botë nuk mund ta imagjinojnë punën e tyre pa e përdorur atë



Balonat (elementet) e demokracisë



Ensara është autorja e balonave të demokracisë

MEDIA NË DEMOKRACI

LABINOT (15), SUELA (14), URTINA (14), ELHAME (15), JEHONA (15), ALTIN (15)

Demokracia është sistem i qeverisjes ku populli udhëheq në vend. Për të udhëhequr populli një vend në mënyrë të drejtë, ata duhet të jenë mirë të informuar

Media është mjet përmes së cilës qytetarët informohen. Këto informata duhet të jenë: të sakta, të drejta dhe të paanshme.

Media ndahet në: media elektronike ku hyjnë rrjetet sociale, radio, televizioni, telefoni etj; si dhe media të shkruara ku hyjnë gazetat, revistat, librat, etj.

Nëpërmjet rrjeteve sociale si Facebook, Instagram apo Twitter, ne mund të informohemi dhe po ashtu komunikojmë me të tjerët. Për shembull, nëpërmjet Facebook-ut jemi informuar nga Klubi i Gjelbër për të pastruar një pjesë të qytetit. Në këtë mënyrë ne kemi marrë pjesë në këtë ngjarje.

Ne si grup ftojmë të gjithë përdoruesit e rrjeteve sociale t'i përdorin ato në mënyrë të drejtë, duke u informuar dhe vetëdijësuar për të mirën publike.



Gazetarët e këtij artikulli




Televizioni, gjithmonë ka qenë mjet i rëndësishëm i informimit



Telefoni mobil, një ndër format më të përdorura të informimit



Gazeta, njëra ndër format më të vjetra të informimit



Twitter, rrjet social që përdoret nga njerëz të ndryshëm



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Nazim Gafurri“
Klasa: IX-5
Vendi: Prishtinë